

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIMAL
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 203/13 prot.

Urë Vajgurore, më 25.01.2024

VENDIM

Nr. 03 Datë 25.01.2024

“Mbi miratimin e kriterëve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për vitin 2024”.

Këshilli i Bashkisë Dimal në mbledhjen e tij të datës 25.01.2024 në bazë të materialit të paraqitur nga Sektori i Ndhmës Ekonomike pranë Bashkisë Dimal në mbështetje të Ligjit Nr 139/2015” Për Vetëqeverisjen Vendore” Neni 53, Neni 54, Neni 55, në mbështetje të Ligjit Nr. 57 datë 10.03.2005 ”Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, i ndryshuar, pika 13 e Kreut II të VKM Nr 57, datë 18.12.2019 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike”, Udhëzimit Nr 5 datë 17.02.2017 “Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%”, të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në mbështetje të Udhëzimit Nr 8 datë 08.05.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin Nr 3 datë 17.02.2017 “Mbi zbatimin e vendimit Nr 57 datë 18.12.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve ,të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike”, udhëzimi nr.57 datë 18.12.2019 “ Për përlllogaritjen e përfitimit të ndihmës ekonomike”, si edhe VKB nr.597, datë 04.09.2019, “Miratimi i kriterëve të ndihmës ekonomike nga fond i kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike 6%”, zbatimit te udhëzimit të Aktit të Kontrollit , me Nr.prot. 149, datë 16.01.2024, nga Shërbimi Social Rajonal, për miratimin e kriterëve cdo vit, urdhërit me nr.540 datë 13.02.2020, VKB nr.3 datë 25.02.2020, VKB-së me nr. 45, datë 15.05.2023.

VENDOSI :

Me 14 vota PRO, nga 14 Këshilltarë prezentë:

1.Të miratohen kriteret e ndihmës ekonomike nga fond i kushtëzuar 6% për vitin 2024 si më poshtë vijon :

- 1.Familje të varfëra të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit.
 - 2.Familje me kryefamiljare femra në vështirësi ekonomike dhe sociale.
 - 3.Familje që kanë në përbërje anëtarë mbi moshë pune, por jo të aftë për punë.
 - 4.Familje me shumë fëmijë.
 - 5.Familje që kanë në përbërje një ose më shumë anëtarë që ndjekin universitetin.
 - 6.Familje që kanë në përbërje një ose më shumë anëtarë me paaftësi/invalid pune.
 - 7.Familje që kanë në përbërjen e tyre, vetëm 2 anëtarë të papunë (kryefamiljari dhe bashkëshortja), të grup moshës 50-60 vjec e deri në moshë pensioni.
2. Masa e ndihmës ekonomike të llogaritet sipas VKM-së, Nr 597 datë 04.09.2019 “ Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike , Udhëzimit Nr 597 datë 04.09.2019 “Për përlogaritjen e përfitimit të ndihmës ekonomike.
 3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
 4. Ngarkohet Sekretari i Këshillit Bashkiak të publikojë vendimin në faqen zyrtare të Këshillit Bashkiak Dimal.
 5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes, sipas përcaktimeve të nenit 55 pika 6 të Ligjit 139/2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore “, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

AVDULLA SALILLARI

